

## **SALI AGAJ**



Përgjegjës sektori i analizës së riskut që nga 1 Tetori 2013. Lindur më 11.12.1954. Diplomuar në Ekonomi(1977).

Autor i disa kumtesave të mbajtura në takimet e Institucioneve të Auditimit.

Vite pune gjithsejt 37, nga këto 21 vite në KLSH.

Fusha e ekspertizës: auditim financiar dhe performance; mardhëniet me jashtë dhe metodologjia e auditimit.

## **ROLI I KLSH-SË NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT<sup>iii</sup>**

*nga Sali Agaj*

Korrupsioni është një problem global i përbashkët për vendet e zhvilluara e ato në zhvillim dhe ka arritur përmasa shqetësuese për shoqërinë njerzore në përgjithësi. Thyerja e barrierave midis sektorit publik dhe privat dhe në veçanti privatizimi i shërbimeve, partneriteti i sektorit publik me atë privat, shkëmbimet e personelit midis dy sektorëve, etj, kanë rritur të ashtuquajturat “zonat gri”, ku konflikti i interesave midis atyre që punojnë në sektorin privat dhe atyre që punojnë në sektorin publik është shumëfishuar. Të gjitha këto zhvillime, pavarësisht të mirave që sjellin, kanë si efekt anësor rritjen e mundësive për korrupsion. Në vendet në tranzicion dukuritë e korrupsionit janë edhe më të dukshme për shkak të intensitetit më të lartë të faktorëve që mundësojnë atë, por edhe të sistemeve të brishta demokratike, të cilat kanë ngritur një rend ekonomik dhe politik të dobët.

“Korrupsioni përfshin sjelljen në mënyrë të paligjshme ose abuzimin me pushtetin nga ana e zyrtarëve në sektorin publik dhe privat, nëpërmjet

dhënies apo pranimit të një favoriti me anë të së cilës ata sigurojnë pasuri ose privilegje për veten dhe/ose të afërmit e tyre.”

Korrupsioni ka pasojat të pallogaritshme në dobësimin e sistemit ekonomik dhe atij politik. Ndër pasojat kryesore mund të përmendim deformimin e konkurrencës, shpërndarjen e padrejtë të burimeve publike dhe shpërdorimin e tyre, shkaktimin e skandaleve që dobësojnë besimin e qytetarëve në institucionet publike, etj. Efekti më i dukshëm i korrupsionit është humbja e besimit publik për politikanët, jetën politike dhe shtetarët në tërësi, besim i cili kërkon një kohë të gjatë që të rikthehet.

Ndikimi mbi biznesin dhe shoqërinë në tërësi është edhe më i madh sepse ai devijon burimet produktive për sektorët joproduktive dhe bën një individ të pasur në kurriz të taksapaguesve, prandaj korrupsioni është cilësuar si taksë mbi të varfërit. Kjo sëmundje rrit rreziqet dhe kostot për biznesin, dëmton besimin e investitorëve, frenon rritjen ekonomike.

Korrupsioni vepron si një pengesë e fortë edhe për investimet e huaja direkte dhe redukton dëshirën e investitorëve të huaj të formojnë ndërmarrje të përbashkëta me kompanitë vendore apo të investojnë drejtpërdrejt.

Për v. 2012 organizata prestigjioze “Transparency International” e renditi vendin tone të 113-in ndër 174 vende të vëzhguara, duke rënë 18 vende më poshtë krahasuar me një vit më parë, duke e klasifikuar kështu të fundit në rajon.

Kontrolli i Lartë i Shtetit si institucioni më i lartë në fushë e auditimit publik duke ushtruar një punë audituese me cilësi të lartë dhe duke gëzuar një shkallë të lartë besueshmërie nga publiku i gjërë, është një instrument i fuqishëm i ligjvënësist për të siguruar përgjegjshmërinë e Qeverisë në drejtim të administrimit të fondeve publike.

Në Progres Raportin e Komisionit European të v. 2013 për Shqipërinë, në mes të tjerash thuhet: “Institucionet shtetërore që merren me luftën kundër korrupsionit vazhdojnë të jenë të dobta ndaj presionit dhe ndikimit politik. Është veçanërisht e rëndësishme të ketë kritere transparente dhe mbi bazën e meritave për emërimet dhe shkarkimet. Duhet të kryhet një vlerësim edhe përsa i takon rolit dhe funksionimit të institucioneve përkatëse si dhe bashkërendimin e punës së tyre, për të forcuar më tej organizimin e përgjithshëm antikorrupsion. Gjithashtu është i nevojshëm përmirësimi i bashkëpunimit me organet e pavarura të kontrollit si Kontrolli i Lartë i Shtetit.”

Megjithëse deri tani për audituesit nuk ka qenë detyre primare zbulimi dhe raportimi i veprave penale korruptive; në kuadrin e thellimit të luftës kundër korrupsionit si një problem global, është e nevojshme që kjo kategori profesionistesh të zotërojë një kuptim më të qartë lidhur me rolin dhe përgjegjësitë e tyre për parandalimin e korrupsionit si dhe në procesin e nxjerrjes së përgjegjësisë për këto vepra penale. Korrupsioni çfaqet me rastet e tangenteve, komisioneve (të shpërblimit) ryshfeteve dhe përfitimeve të tjera pa lënë gjurmë në dokumentet zyrtare, ndërsa mashtrimi konsiston në përfitime të pamërituara, duke anashkaluar kontrollet e duke shkelur dispozitat. Kjo dmth që në rastin e një mashtrimi mbeten gjurmë në dokumentat e subjekteve përkatës (publike dhe private) e veçanërisht në dokumentet financiare.

I pranishëm në Konferencën Kombëtare të Luftës kundër Korrupsionit të zhvilluar në Tiranë me 12 - 13 Nëntor 2013, në fjalën e tij Kryetari i KLSH-së z. Leskaj theksoi:

“Ka ardhur koha ta ngremë stekën në luftën kundër korrupsionit. Veçmas, asnjë institucion nuk maksimizon punën e vet. Edhe ekspertiza e vyer dhe kontributi i institucioneve donatore ndërkombëtare nuk arrin të

maksimizohet, pa sinergjizimin e përpjekjeve të institucioneve publike dhe shoqërisë civile të vendit.”

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rritur nivelin e performancës, si me rritjen e numrit të auditimeve ashtu edhe cilësinë e tyre. Nga auditimet e ushtruara për v. 2012 u konstatuan shkelje me dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit 97.1 milionë euro ndërsa për 9 mujorin 2013 në shumën prej 104.2 milionë euro (nga 50 milion euro të konstatuara në vitin 2011).

Gjatë periudhës 2012 - 2013, janë bërë 65 kallëzime penale në organet e prokurorisë për 186 persona përgjegjës të administratës shtetërore, ku vlera totale e dëmit të shkaktuar si pasojë e veprimeve të tyre të kundraligjshme është rreth 13.3 milionë euro. Vetëm gjatë v. 2012 u depozituan dy herë më shumë kallëzime se gjatë tre viteve të marra së bashku (2009, 2010, 2011).

Duke folur për këto dukuri në Konferencën kundër korrupsionit, z. Leskaj u shpreh: “Për fat të keq, një pjesë e mirë e këtyre zyrtarëve, ndaj të cilëve KLSH ka depozituar kallëzim penal, kanë vazhduar apo vazhdojnë të ushtrojnë funksionet e tyre publike, pavarësisht faktit që legjislacioni në të tilla raste parashikon pezullimin apo largimin e tyre nga detyra. Kjo dukuri ka ardhur nga mungesa e përgjegjshmërisë dhe vullnetit të institucioneve të audituara në ndëshkimin e shkelësve të ligjit brenda stafit të tyre, duke ndikuar në perceptimin e natyrshëm negativ që opinioni publik ka ndaj angazhimit serioz të organeve shtetërore në luftën kundër korrupsionit.”

Shkeljet financiare janë vërejtur kryesisht në prokurimet publike, në shitjen dhe dhënien me qira të pasurive shtetërore, në urbanistikë, në shpenzimet operative, në doganat, në tatimet e taksat, etj. Duhet theksuar se më shumë se dy të tretat e rekomandimeve të propozuara nga ana e KLSH-së janë zbatuar nga subjektet e audituara.

Strukturat e auditimit të brendshëm të organeve ekzekutive nuk mund të ndryshojnë shumë në luftën kundër korrupsionit, sepse ato nuk mund të propozojnë rekomandime përtej asaj që mund të zbatohen nga subjektet e audituara. Shumë masa që kërkojnë vullnet politik duhet të merren nga qeveria. Për veprime të tilla, vetëm një institucion si KLSH që ka pavarësinë dhe burimet e duhura për të luajtur këtë rol mund të marrë iniciativën.

Në Konferencën e luftës kundër korrupsionit Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes Ahmetaj, e quajti "të dështuar" auditimin e brendshëm, por në se këto struktura kanë dështuar, i kujt është faji? Organet ekzekutive nuk kanë qenë të vetdijshme për të ndërtuar një auditim të brendshëm të bazuar në standarde, por e kanë konsideruar atë si një "kthinë" për militantët, kushërinjtë apo miqtë e deputetëve apo të funksionarëve. Aktualisht këto struktura kanë 391 punonjës ose rreth 3 herë më shumë se stafi auditues i KLSH-së (megjithëse këto struktura u krijuan me ligj që në v. 2003 mbi 40 % të audituesve të këtij kanë më pak se 5 vjet pune). Pa folur këtu për strukturën e zbulimeve, niveli i zbulimeve gjithsej të raportuar nga auditimi i brendshëm është 5 herë më i ulët se niveli i KLSH-së?

Roli dhe përgjegjësitë e KLSH-së në luftën kundër korrupsionit mund të përmbledhen si më poshtë:

- identifikimi i mangësive strukturore, procedurale dhe organizative brenda organizatave që auditohen ose këshillohen si dhe raportimi i tyre në nivelet më të larta menaxheriale;
- mbështetja dhe inkurajimi i auditimit të brendshëm të organizatave që auditohen duke ndikuar kështu në përmirësimin e administrimit dhe për pasojë, në marrjen e masave proaktive parandaluese kundër korrupsionit;

- identifikimi i kompetencave të tepruara në duart e vendimmarrësve dhe rekomandimi për ridimensionimin e tyre në mënyrë që të mos demtohet eficientia në menaxhim dhe nga ana tjetër, të minimizohet mundësia e vendimmarresve për korrupsion.
- nëpërmjet auditimeve të performancës, shtrirja e sferes së auditimit jashtë subjektit të audituar për të vlerësuar në terren sesa të kënaqur janë përdoruesit; në ato raste kur organizimi i strukturave të brendshme vendimarrëse, procedurat dhe kontrolli i brendshëm janë formalisht në rregull.
- konsultimi i burimeve të jashtme të informacionit sa herë që është e nevojshme që të arrihet një përfundim në lidhje me faktin nëse subjekti i audituar është implikuar në afere korruptive.
- auditimi i llogarive të subjekteve taksapagues, si burim i evazionit fiskal dhe humbjeve të konsiderueshme për buxhetin e shtetit
  - marrja e sugjerimeve dhe ndërveprimi me shoqërinë civile rreth auditimit të atyre zonave ku njerëzit mendojnë se ka mundësi më të mëdha për korrupsion
  - publikimi i raporteve të auditimit në gjuhë shumë të kuptueshme për publikun e gjerë. Kjo do të inkurajonte publikun të ketë interes për çështjet e shtetit dhe të kerkonte transparencë nga ekzekutivi.

Së fundi megjithëse kjo është një temë shumë e gjerë që përbën subjekt për një shkrim tjetër desha të shtoja rëndësinë e madhe që ka media si pushtet i katërt në luftën kundër korrupsionit. Javën e kaluar, në emisionin “Opinion” të TV Klan, për t’u përgjigjur ‘flakë për flakë’ konferencës së lartpërmendur po diskutohej mbi korrupsionin. Ajo që binte në sy ishte se jo vetëm që paneli linte për të dëshiruar, por për këtë temë kritike për të ardhmen e shtetit ligjor edhe diskutimet ishin të një niveli të ulët të tilla si: ‘nga erdhi

korrupsioni nga lindja apo perëndimi’, ‘a është bakshishi korrupsion’, ‘njeriu a lind apo bëhet i korruptuar’, etj. Aty nuk ishte ftuar asnjë përfaqësues i institucioneve shtetërore që merret me luftën kundër korrupsionit apo ndonjë politikan e qeveritar si persona përgjegjës për shkallën e lartë të korrupsionit në vend, ndërkohë që politikanët e funksionarët e shtetit i gjen vend e pa vend në emisionet televizive edhe për çështje që duket haptas se janë profanë.

Ky episod më kujtoi emisionin e komentatorit të njohur politik Bill O’Reilly të televizionit amerikan Fox News, “No Spin Zone”, emision të cilin ai e quan “një makth për sharlatanët dhe mashtruesit”, me të cilin ai i ka hedhur “dorashkën” politikanëve dhe qeveritarëve të Amerikës, sentencën “Kujt t’ia mbajë, të vijë në emisionin tim!”

---

<sup>i</sup> Botuar në gazetën “Tirana Observer” dt. 20 nëntor 2013

<sup>ii</sup> Shkrime të tjera të autorit (të papërfshira në këtë botim) gjatë vitit 2013:

- Mundësitë e rritjes së të ardhurave nga akcizat (Ekonomia, 13 qershor 2013)
- Mundësitë e rritjes së të ardhurave nga Aksiza në Buxhetin e Shtetit (Tirana Observer 25 shtator 2013)
- Borxhi doganor dhe disa probleme që lidhen me te (“Tirana Observer”...)